



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2011  
Nr. ref.: RK132/11

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI-63/09

Parashtruesi

Bajram Santuri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 368/2000, të 8 majit 2003, Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 46/2005 (C. nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, si dhe të vendimeve të gjykatave në Suedi dhe aktgjykimeve Nr. 8329/06 dhe 9095/07 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjylleta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

### Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bajram Santuri, nga Prizreni.

## Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kérkesës konteston aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 368/2000, të 8 majit 2003 dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006.
3. Ai po ashtu, ankohet në lidhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), Nr. 8329/06 dhe 9095/07, të 26 shtatorit 2006, respektivisht 18 shtatorit 2007, në raste të ndara kundër Suedisë.

## Objekti i çështjes

4. Kérkesa ka të bëjë me dy çështje:

### (1) Çështja e pronës

5. Parashtruesi i kérkesës pretendon se vendimet e lartpërmendura të gjykatave të Kosovës në lidhje me çështjen e pronës i shkelin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe nenin 37 [E drejta e martesës dhe familjes] të Kushtetutës.

### (2) Çështja e të drejtës në familje

6. Parashtruesi i kérkesës kérkon nga Gjykata të shqyrtojë vendimet e GJEDNJ-së, me të cilat kérkesat e tij Nr. 8329/06 dhe 9095/07 u hodhën poshtë më 26 shtator 2006, respektivisht më 18 shtator 2007.

## Baza juridike

7. Neni 113 (7) i Kushtetutës, nenet 20 dhe 22 (7) dhe (8) të Ligjit (Nr. 03/L – 121) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Regullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 15 dhjetor 2009, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
9. Më 6 korrik 2010, Gjykata ia komunikoi kérkesën Gjykatës Komunale e cila u përgjigj më 20 korrik 2010.
10. Me vendim të Kryetarit (Nr. GJR. 63-09/10, të 23 dhjetorit 2009), gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj u emërua Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me vendim nr. KSH. 63-09/10 Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrties të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova.
11. Më 29 mars 2011, u kérkuan të dhëna shtesë në lidhje me gjendjen e rastit nga Gjykata Komunale në Prizren e cila u përgjigj më 1 prill 2011.

## Historiku i çështjes së pronës

12. Gjyshi i parashtruesit të kérkesës vdiq më 1953, dhe la pas vetes, nga martesa e parë, gjyshen e parashtruesit të kérkesës dhe babanë, si dhe nga martesa e dytë, bashkëshorten e dytë dhe pesë fëmijë.

13. Parashtruesi i kérkesës ankohet se prona e gjyshit të tij i ishte bartur në emër të bashkëshortes së dytë dhe iu nda pesë fémijëve të saj, me ç'rast u përjashtua nga pasuria babai i parashtruesit të kérkesës. Parashtruesi i kérkesës nuk e përmend nëse gjyshja e tij mori hise të trashëgimisë apo jo.

### **Përbledhja e fakteve sa i përket çështjes së pronës**

14. Me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren C. nr. 50/55, të 25 nëntorit 1955, si trashëgimtarë të ligjshëm të gjyshit të parashtruesit të kérkesës u shpallën: bashkëshortja e dytë e gjyshit, babai i parashtruesit të kérkesës si dhe pesë fémijët e bashkëshortes së dytë të gjyshit. (Bashkëshortja e parë e gjyshit nuk përmendet fare në vendimin e lartpërmendor). Prona në fjalë përbëhej nga shtëpia dhe oborri në adresën: rruga Petar Stamboliq, nr. 77; një ngastër me shitore në adresën: rruga Boris Kidriq, nr. 65, në Prizren; dhe një ngastër prej 2 hektarësh në Llëka. Sipas vendimit të gjykatës, secili trashëgimtar kishte të drejtë në një të shtatën (1/7) e tërë pronës së gjyshit të ndjerë.
15. Me barazimin gjyqësor R. nr. 279-56, të 14 majit 1956, të lidhur në Gjykatën e Qarkut në Prizren, në mes të babait të parashtruesit të kérkesës, në njëren anë, dhe gjashtë trashëgimtarëve tjerë, në anën tjetër, ishte vendosur që babai i parashtruesit të kérkesës do të merrte shitoren në rrugën Boris Kidriq, nr. 65, në Prizren, ndërsa të tjerët do të merrnin shtëpinë në pronësi të përbashkët si dhe 2 hektarë tokë. Gjithashtu, 6 trashëgimtarët tjerë ishin urdhëruar që t'i paguanin babait të parashtruesit të kérkesës shumën prej 34.000 dinarë deri më 1 nëntor 1956. Mirëpo, para se të kalonte afati i pagesës së parave, në qershori tjetër të vitit 1956 vdiq babai i parashtruesit të kérkesës. Sipas parashtruesit të kérkesës, gjashtë trashëgimtarët tjerë kurrë nuk e paguan shumën në fjalë.
16. Me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren O – Nr. 123/56, të 24 tetorit 1956, nëna e parashtruesit të kérkesës, e cila e kishte edhe një djalë tjetër të mitur (vëllai i parashtruesit të kérkesës) u shpall trashëgimtar i vetëm. Babai i ndjerë i parashtruesit të kérkesës ishte pronar i një ngastre dhe një shitore në adresën: rruga Boris Kidriq, nr. 65, në Prizren, me vlerë prej 70.000 dinarëve të asaj kohe. Në Gjykatën e Qarkut në Prizren, nëna e parashtruesit të kérkesës kishte dekluaruar në emër të saj dhe fémijëve të saj të mitur se e kishte pranuar trashëgiminë, dhe në bazë të ligjit, po ashtu ua njihte të drejtën e trashëgimisë fémijëve të saj të mitur.
17. Më 1 qershor 1964, bashkëshortja e dytë e gjyshit të parashtruesit të kérkesës, axha dhe halla ia shitën pronën e patundshme në vendin "Lleka" (transaksion që është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren) KBI Progres-"Lavërtaria" nga Prizreni. Më 24 mars 1966, KBI Progres-"Lavërtaria" ia shiti pronën palës së tretë nga fshati Hoqë e Qytetit. Kontrata në fjalë u vërtetua në Gjykatën Komunale të Prizrenit, leg.nr. 382/66 në të njëjtën ditë.
18. Me kérkesë të Prokurorit publik, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin p. nr. 348/95, të 4 qershorit 1998, ,e shfuqizo kontratën e shitblerjes leg. nr. 920/64, të datës 1 qershor 1964, të lidhur në mes të bashkëshortes së dytë të gjyshit, axhës, hallës së parashtruesit të kérkesës, dhe KBI "Progres", si dhe të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren, me arsyetimin se palët në atë kohë ishin të detyruara nga ana e aktivistëve të komunës dhe komitetit që të pajtoheshin me kontratën.
19. Më 8 maj 2003, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C. nr. 368/00 e miratoi kérkesë-padinë e axhës dhe hallës së parashtruesit të kérkesës dhe e e shfuqizo kontratën e shitblerjes të lidhur në mes të KBI "Progres" dhe palës së tretë nga fshati Hoqë e Qytetit, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren leg. nr. 382/66, të 24

marsit 1966. Gjykata po ashtu, e urdhëroi KBI “Progres” dhe palën e tretë që të pranojnë aktgjykimin dhe të bëjnë bartjen e të drejtave të pronësisë dhe posedimit tek axha dhe halla e parashtuesit të kërkesës, për secilin, gjysmën e hises në ngastrën kadastrale nr. 9437 në vendin e quajtur “Llëka”, siç tregohet në listën poseduese nr. 7275 KK Prizren.

20. Më 1 qershor 2004, Gjykata Komunale në Prizren me Vendimin E. nr. 14/2000, e pezulloi procedurën e përmbarimit, të ngritur nga ana e parashtuesit të kërkesës për të përmbaruar barazimin gjyqësor Nr 279-56, të 14 majit 1956, të lidhur në mes të babait të parashtuesit të kërkesës dhe gjashtë trashëgimtarëve tjerë të gjyshit të ndjerë të parashtuesit të kërkesës për shkak të parashkrimit. Gjykata vendosi që parashtuesi i kërkesës e kishte dorëzuar kërkesën për përmbarimin e barazimit gjyqësor, të datës 14 maj 1956, jashtë afatit kohor, pasi që nga data e nënshkrimit të barazimit kishin kaluar më shumë se dhjetë (10) vjetë; prandaj, në bazë të nenit 379 (1) të Ligjit për Marrëdhëni Detyrimore, kërkesa e parashtuesit për përmbarim ishte e parashkruar.
21. Gjykata e Qarkut në Prizren, me Vendimin Ac. nr. 354/05, të 17 tetorit 2005, e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtuesit të kërkesës ndaj Vendimit të Gjykatës Komunale E. nr. 14/2000, të 1 qershorit 2004. Gjykata e Qarkut konkludoi se gjykata e shkallës së parë kishte vendosur në mënyrë të drejtë, kur e kishte pezulluar procedurën e përmbarimit, sepse parashtuesi i kërkesës kishte kërkuar përmbarimin e barazimit gjyqësor R. nr. 279-56, të 14 majit 1956, pas afatit kohor.
22. Pastaj, parashtuesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, e cila më 15 gusht 2006, e refuzoi kërkesën e parashtuesit për revizionin si të papranueshme, me arsyetimin se Gjykata Komunale në Prizren, me Vendimin E.nr 14/2000, të datës 1 qershor 2004, e kishte pezulluar procedurën e përmbarimit të iniciuar nga parashtuesi i kërkesës, kundër debitorëve, për shkak të parashkrimit dhe se Gjykata e Qarkut, me Vendimin Ac. nr. 354/2005, të 17 tetorit 2005, e kishte hedhur poshtë ankesën e tij si të pabazuar dhe me atë rast e kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Komunale të 1 qershorit 2004.
23. Më 28 dhjetor 2006, Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin Rev. nr. 46/2005, të 28 dhjetorit 2006, në çështjen juridike lidhur me bashkëshorten e dytë të gjyshit të parashtuesit të kërkesës, axhën dhe hallën, në njëren anë dhe KBI Progres-“Lavërtaria” dhe palës së tretë nga fshati Hoqa e Qytetit në anën tjetër, e miratoi kërkesën për revizion, si dhe kërkesën e Prokurorit publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë, me ç'rast i anuloi vendimet e gjykatave të ulëta dhe e ktheu lëndën në Gjykatën Komunale të Prizrenit për gjykim të mëtutjeshëm me numër të ri të dosjes C 99/07.
24. Më 27 shkurt 2008, parashtuesi i kërkesës i propozoi Gjykatës Komunale në Prizren që t'i lejojë të ndërhyjë në procedurën gjyqësore të axhës dhe hallës së tij kundër KBI Progres-“Lavërtaria” dhe palës së tretë nga fshati Hoqa e Qytetit.
25. Gjykata Komunale në Prizren, me vendimin Agj. nr. 17/2009, të 16 dhjetorit 2009, e miratoi si të bazuar kërkesën e parashtuesit në cilësinë e paditësit dhe ndërhyrësit për përjashtimin e gjyqtarit, kundër të cilit parashtuesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë, nga rasti C. nr. 99/07.
26. Në përgjigje të kërkesës për të dhëna të dérguara nga Gjykata Kushtetuese në rastin KI 63/09, kryetari i Gjykatës Komunale të Prizrenit theksoi se kërkesa e parashtuesit për të marrë pjesë në procedurë, në cilësinë e ndërhyrësit, në rastin C. nr. 99/07, pas deklaratave të palëve ndërgjyqëse, ishte miratuar, siç është regjistruar në procesverbalin e 7 korrikut 2010.

27. Deri më tanë, në rastin C. nr. 99/07, kryetari i Gjykatës Komunale ka caktuar 7 seanca, por disa nga to është dashur të shtyhen sepse nuk ishin plotësuar të gjitha parakushtet procedurale. Seanca e radhës ishte caktuar për 16 shtator 2010, pasi që përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse ishin pajtuar që të kenë më shumë kohë për shqyrtim dhe përgatitje, pasi që kjo ishte një çështje voluminoze që është zhvilluar nga vitet e 50-ta të shekullit të kaluar. Sidoqoftë, më 16 shtator 2010 Gjykata Komunale vendosi të pezullojë procedurën në këtë çështje pas vdekjes së të paditurës së katërt, hallës së parashtruesit të kërkesës.
28. Në bazë të një ankese, të ushtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës më 16 dhjetor 2010 kundër pezullimit të procedurës, dosja e lëndës u dërgua në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit për procedim të mëtutjeshëm. Deri më tanë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë informacion në lidhje me ndonjë përfundim të mundshëm të këtyre procedurave gjyqësore.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me çështjen e pronës**

Sa i përket çështjes së pronës:

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 368/2000, të datës 8 maj 2003 dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. 46/2005 (C. Nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e Gjykatës Komunale të datës 8 maj 2003, atij i ishte bërë një padrejtësi, pasi që ai nuk kishte qenë palë në këtë procedurë, pasi që dyshohej se Gjyqtari kryesues kishte marrëdhënie familjare me palët tjera në procedurë.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 46/2005 (C. Nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, ai përjetoi edhe një padrejtësi tjetër, pasi që nuk ka mundur të përfshihet në procedurë, dhe me atë rast ishte parandaluar në gëzimin e të drejtës së supozuar në hise, përderisa Gjykata Supreme nuk ka qenë plotësisht në dijeni për të gjitha faktet.
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij si fëmijë janë shkelur që nga viti 1956 pasi që gjatë asaj kohe babai i tij e ka ndarë pronën e trashëguar me anëtarët e familjes së tij dhe, kur babai i tij vdiq në vitin 1956, ai nuk kishte qenë në gjendje të realizojë hisen e tij, pasi që ka qenë i mitur. Sipas parashtruesit të kërkesës, anëtarët e familjes së babait të tij e kanë shfrytëzuar dhe keqpërdorur situatën duke marrë hisen e babait të parashtruesit të kërkesës (vëllait të tyre të ndjerë).
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se hisja e babait të tij nuk u realizua pasi që ai vdiq më 13 qershori 1956, ndërsa hisja është dashur të realizohet më 1 nëntor 1956, siç shkruan në barazimin gjyqësor të 14 majit 1956, të lidhur në mes të babait të parashtruesit të kërkesës dhe anëtarëve të familjes së tij, përkundër faktit se Gjykata e Qarkut në Prizren me Vendimin O-nr. 123-56, të 24 tetorit 1956, kishte vendosur që nëna e tij, ai dhe vëllai i tij si të mitur, të jenë të vetmit trashëgimtarë të pronës së babait të tij të ndjerë.

### **Përbledhja e fakteve në lidhje me çështjen e familjes**

Më 16 shkurt 2006, shërbimet e sigurimit social në Suedi vendosën që të ndalojnë kontaktet në mes të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes e vajzës së tij, vendim që është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë me Vendimin nr. 554-06, të 13 marsit 2006.

34. I pakënaqur me vendimet gjyqësore parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë, në dy raste, në GJEDNJ në Strasburg, kundër Qeverisë Suedeze. Kërkesa e parë u dorëzua më 27 mars 2006, ndërsa kërkesa e dytë më 15 janar 2007.
35. Më 26 shtator 2006, një koleg prej tre gjyqtarësh të GJEDNJ-së, në bazë të nenit 27 të Konventës, vendosi që kërkesa Nr. 8329/06 ishte e papranueshme, mbi bazë të asaj se nuk kishte gjetur asnjë gjurmë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me konventë apo me protokollet e saj. Në lidhje me këto dy kërkesa, GJEDNJ nxori Vendimin nr. 8329/06, të 26 shtatorit 2006, respektivisht Vendimin nr. 9095/07, të 18 shtatorit 2007.
36. Kërkesa e dytë u shqyrtua nga një koleg prej 3 gjyqtarësh të GJEDNJ-së më 18 shtator 2007, në bazë të nenit 27 të Konventës, i cili vendosi që kërkesa Nr. 9095/07 ishte po ashtu e papranueshme, për shkak se ankesa e tanishme ishte në esencë e njëjtë me kërkesën paraprake (Kërkesa Nr. 8329/06) dhe nuk përbante fakte të reja.
37. Parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në gjykatat e rregullta dhe në Gjykatën e Lartë të Suedisë kundër tre personave: përgjegjësit të Spitalit Universitar të Lundtit, Seksioni Neonatal i Departamentit të Grave (Padia nr. B1044-06 e datës 2 maj 2006), një punëtori të një çerdheje në Alvesta (Padia nr. B 155-06 e 10 tetorit 2006) dhe një punëtori tjetër të çerdhes në Alvesta (Padia nr. B 155-06 e po të njëjtës ditë). Në të tri rastet, paditë e parashtruesit të kërkesës u hodhën poshtë nga gjykatat e lartpërmendura.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje çështjen e familjes**

38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e GJEDNJ-së në lidhje me kërkesat Nr. 8329/06, të 26 shtatorit 2006 dhe Nr. 9095/07, të 18 shtatorit 2007, ishin të njëanshme dhe të padrejta ndaj tij dhe familjes së tij, sepse siç pohon parashtruesi i kërkesës, këto vendime u morën nga kolegjet e GJEDNJ-së të përbëra nga gjyqtarë suzedezë dhe jugosllavë, të cilët i mbronin interesat e tyre kundër kërkesës së parashtruesit, me të cilën kritikohet shteti suzedez dhe ish-Jugosllavia.
39. Parashtruesi i kërkesës më tutje pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta në Suedi, me të cilat hedhet poshtë padia e tij kundër përgjegjësit të spitalit universitar të Lundtit dhe dy punëtorëve të çerdhes në Alvesta, ishin rezultat i racizmit dhe ksenofobisë së suzedezëve dhe Suedisë ndaj të huajve. Si provë, parashtruesi i kërkesës i referohet një libri në suedisht të quajtur “Social Vanvard”, dhe një numri të CD-ve, shënimeve dhe fotografive.
40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, për arsyet e racizmit dhe përfitimit material, autoritete suzedez e kanë ndarë atë nga bashkëshortja e parë si dhe nga bashkëshortja e dytë dhe bebja e tyre, duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte gjoja në gjendje të paqëndrueshme mendore për të mbajtur familjen e tij.

### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë**

#### **(1) Sa i përket çështjes së pronës**

41. Parashtruesi i kërkesës ankohet se me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 368/2000, të 8 majit 2003, dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. 46/2005 (C. Nr. 99/07), të 28 dhjetorit 2006, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe paanshëm] të Kushtetutës.
42. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata vëren se për të qenë në gjendje për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, ajo së pari duhet kontrollojë nëse parashtruesi i

kérkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

43. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se përveç faktit se parashtuesi i kérkesës qartazi nuk ka qenë palë në këto procedura, vendimet relevante gjyqësore ndaj të cilave ai ankohet, janë të datës 8 maj 2003 (Vendimi i Gjykatës Komunale), respektivisht të datës 28 dhjetor 2006 (Vendimi i Gjykatës Supreme). Kjo do të thotë se ankesat e tij në lidhje me këto procedura gjyqësore kanë të bëjnë me ngjarje që kanë ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës. Prandaj, Gjykata nuk ka juridikSION që të shqyrtojë këto ankesa.
44. Pra, rezulton që kjo pjesë e kérkesës nuk është në pajtim “*ratione temporis*” me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, Jasioniene kundër Lituanisë, Kérkesa Nr. 415101/98, Aktgjykimet e GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 9 qershorit 2003; si dhe, Rasti Nr. KI 61/09, “Adler Com” Sh.p.k., Vlerësim i kushtetutshmërisë të vendimit të Komunës së Gjakovës, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 16 dhjetor 2010).
45. Gjykata më tutje vëren se me vendimin e 7 korrikut, Gjykata Komunale në Prizren, të cilës lënda në të cilën parashtuesi i kérkesës nuk ishte palë, i ishte transferuar nga Gjykata Supreme me vendimin e 28 dhjetorit 2006 me numër të ri të lëndës C. Nr. 99/07, e miratoi kérkesën e parashtuesit për të marrë pjesë në procedurë në cilësinë e ndërhyrësit. Megjithatë, kur Gjykata Komunale e pezulloi procedurën me vendimin e 16 shtatorit 2010, parashtuesi i kérkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër vendimit për pezullim. Parashtuesi i kérkesës nuk ka dorëzuar ndonjë informacion në lidhje me përfundimin e kësaj procedure gjyqësore.
46. Në këto rrethana, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit, të cilët parashikojnë që parashtuesi i kérkesës mund të parashtrrojë kérkesë në Gjykatë, pasi t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Arsyetimi për rregullin e shterjes së mjeteve bëhet në mënyrë që t'u mundësohet autoritetetevë përkatëse, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë e parandalimit apo korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli është i bazuar në supozimin se rendi juridik në Kosovë do të ofrojë mjete efektive kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih, *inter alia*, Aktvendimin për Papranueshmëri KI41-09 Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2010 dhe, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).
47. Pra rrjedhimisht kjo pjesë e kérkesës është e papranueshme.

## **(2) Sa i përket çështjes së familjes**

48. Sa i përket pretendimeve të parashtuesit të kérkesës se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], dhe nenin 37 [E drejta e martesës dhe e familjes] të Kushtetutës, Gjykata edhe njëherë thekson se, për të qenë në gjendje për të gjykuar për ankesën e parashtuesit ajo së pari duhet kontrollojë nëse parashtuesi i kérkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, ngjarjet që kanë ndodhur në Suedi si dhe vendimet e GJEDNJ-së, për të cilat ankohet parashtuesi i kérkesës, nuk janë të ndërlidhura me autoritetet publike në Kosovë, siç kerkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe 47(1) të Ligjit, dhe rrjedhimisht bien jashtë juridikSIONIT të Gjykatës.

50. Prandaj, rezulton që kjo pjesë e kërkesës duhet të hedhet poshtë si “*ratione personae*” e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e mbajtur më 6 korrik 2011, njëzëri,

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Dr.Gjyljeta Mushkolaj



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

